

11 shtator, 2007

Komunikatë për media

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit shtynë valën e 28-të të privatizimit

PRISHTINË –Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) njofton mbi shtyrjen e valës së 28-të të privatizimit. Vendimi për të shtyrë këtë valë është marr për shkak të disa problemeve teknike, siç janë çështjet kadastrale dhe mos kompletimi i dokumentacionit.

Për të siguruar se tenderi do të jetë i drejtë dhe i hapur, si dhe për të siguruar që të gjithë investitorët të kenë kohë të mjaftueshme ta kryejnë hulumtimin paraprak, AKM-ja vendosi që të shtyjë ditën e ofertimit nga e mërkura më 19 shtator, 2007 për të mërkurën më 17 tetor, 2007.

AKM-ja shpreh keqardhje për çfarëdo shqetësimi që kjo të mund ti ketë shkaktuar ofertuesve të mundshëm .

Lista e kompletuar e ndërmarrjeve në dispozicion për shitje në valën e 28-të të privatizimit do të jetë në publikohet së shpejti.

FUND